Kërkesa për kapital për rrezikun e kredisë dhe rrezikun e kredisë së kundërpartisë, sipas metodës standarde, është e barabartë me 12% të totalit të ekspozimeve dhe ekspozimeve të mundshme të ponderuara me peshat e rrezikut.

Vlera e ekspozimit është vlera e tij në bilanc, ndërsa vlera e ekspozimit të mundshëm, siç përcaktohet në rregulloren për Mjaftueshmërinë e Kapitalit, do të jetë një përqindje e vlerës së tij, sipas klasifikimit në kategoritë e rrezikut, si më poshtë:

- a) 100% e vlerës së tij, për kategorinë me rrezik të lartë;
- b) 50% të vlerës së tij, për kategorinë me rrezik të mesëm;
- c) 20% të vlerës së tij, për kategorinë me rrezik të ulët;
- d) 0% të vlerës së tij, për kategorinë pa rrezik.

Banka llogari vlerën e ekspozimit përkatës, pas zbritjes së fondeve rezervë për mbulimin e humbjeve

## 7.2 Vlerat e ekspozimeve sipas cilësisë së kredisë para dhe pas aplikimit të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë

	Ekspozimi original para faktoreve të konvertimit (neto nga rregullimet e vlerës dhe provigjionet)	Ekspozimi neto pas efektit zëvendësues të teknikave të zbutjes së kredisë, përpara aplikimit të faktorëve të konvertimit	Metodat e zbutjes së rrezikut të kredisë që prekin vlerën e ekspozimit: Mbrojtja e kredisë e financiar, metoda e kolateralit financiar, metoda gjithëpërfshirëse.		Vlera e ekspozimit e rregulluar plotësisht (E*)	Ndarja e ekspozimeve të rregulluara plotësisht të zërave jashtë bilancit sipas faktoreve të konvertimit				Vlera e ekspozimit	Shuma e ekspozimeve të klasifikuara sipas rrezikut	Nga e cila: me cilësi të kredisë të derivuar nga cilësia e kredisë së qeverisë qëndrore.
			(-) Kolaterali financiar: Vlera e rregulluar (Cvam)	(-) Rregullimet e luhatshmërisë dhe maturitetit		0%	20%	50%	100%			
	040	110=040-090+100	130	140	150 = 110 + 120 - 130	160	170	180	190	200=150-160-0,8*170-0,5*180	220	240
<b>Totali i ekspozimeve</b>	34,656,665,500	34,656,665,500	676,551,095	6,159,582	33,980,114,405	379,221,728	203,152,609	129,210,586	18,459,243	33,373,765,297	12,195,449,781	374,938,489
<b>Ndarja sipas llojit të ekspozimit</b>												
Zërat e bilancit subjekt i rrezikut të kredisë	33,372,089,017	33,372,089,017	122,018,778	5,891,900	33,250,070,239					33,250,070,239	12,114,462,918	
Zërat jashtë bilancit subjekt i rrezikut të kredisë	1,284,576,483	1,284,576,483	554,532,317	267,682	730,044,166	379,221,728	203,152,609	129,210,586	18,459,243	123,695,058	80,986,863	
Transaksio net e financimit të letrave me vlerë		-			-							



## 8. Rreziqet e tregut: Informacion i përgjithshëm

### 8.1 Informacion i përgjithshëm

Risku i tregut është risku që ndryshimet në çmimet e tregut, si norma e interesit, çmimet e kapitalit, kurset e këmbimit të monedhave të huaja, nivelet e kredisë (jo të lidhura me ndryshime të gjëndjes së debitorit/memetuesit) do të ndikojnë fitimet e Bankës ose vlerën e instrumenteve financiare. Objektiv i menaxhimit të riskut të tregut është të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimet ndaj riskut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin mbi riskun.

Risku i kursit të këmbimit përkufizohet si mundësia që luhatjet e kurseve të këmbimit të krijojnë ndryshime të konsiderueshme, pozitive ose negative në pasqyrën e pozicionit financiar të Bankës. Burimet më të rëndësishme të riskut të normës së këmbimit konsistojnë në:

- Huadhëniet në monedhë të huaj dhe depozitat në monedhë të huaj të korporatave dhe individëve;
- Investime në letrat me vlerë;
- Tregtimi i kartëmonedhave të huaja;
- Arkëtimi ose pagesa e interesit, komisioneve, kostove administrative, etj. në monedha të huaja.

Banka, në rastet kur pozicioni total neto i hapur valutor i saj, i përcaktuar në rregulloren “Për administrimin e rrezikut nga pozicionet e hapura valutore”, është më i lartë se 2% e kapitalit rregullator, shumëzojnë me 8% vlerën e këtij pozicioni, për llogaritjen e kërkesës për kapital rregullator për rrezikun e kursit të këmbimit.

### 8.2 Kërkesa për kapital rregullator për rrezikun e kursit të këmbimit

	Te gjitha pozicionet		Pozicionet neto		Kërkesa për kapital (%)		Kërkesa për kapital	Ekspozimet e ponderuara me rrezik
	Në blerje	Në shitje	Në blerje	Në shitje	Në blerje	Në shitje		
	020	030	040	050			090	100
Pozicionet totale në monedhë të huaj	15,250,090,578	14,894,981,853	355,268,622	159,896			28,421,490	355,268,622
<i>Të gjitha monedhat (duke përfshirë investimet në SKI të trajtuara si monedhë e vecantë)</i>	15,250,090,578	14,894,981,853	355,268,622	159,896	8.00	8.00	28,421,490	
<b>Ndarja e pozicioneve sipas llojit të instrumentit</b>								
<i>Instrumenta financiare</i>	15,087,885,948	14,746,387,222						
<i>Zëra jashtë bilancit</i>	162,204,630	148,594,630						

## 9. Rreziku operacional

### 9.1 Informacion i përgjithshëm

Rreziku operacional është rreziku i humbjes së Bankës si rezultat i proceseve të brendshme te papërshtatshme ose te keqpërdorura, dështimit të proceseve të brendshme; gabimeve njerëzore dhe të sistemeve; ngjarjeve të jashtme ose risku ligjor. Banka ka hartuar një kuadër të brendshëm rregullativ i cili mundëson matjen, vlerësimin dhe monitorimin e këtij rreziku nëpërmjet instrumentave si më poshtë:

- Baza e të dhënave e raportimeve të brendshme;
- Risk mapping (harta e rreziqeve);
- Paralajmërimet e rreziqeve operacionale;

Monitorimi i Rrezikut Operacional sipas instrumentave të lartpërmendura raportohet në Komitetin e Çështjeve Sensitive dhe Provigjionimit në raporte mujore, tremujore dhe vjetore si dhe në Bordin e Drejtorëve.

Banka llogarit kërkesën për kapital për rrezikun operacional, sipas metodës së treguesit të thjeshtë, e cila konsideron të ardhurën neto nga veprimtaria bankare për tre vitet e fundit të veprimtarisë së bankës dhe një koeficient  $\alpha$  prej 15%.

### 9.2 Kërkesa për kapital rregullator për rrezikun operacional

Aktiviteti bankar		Treguesi			Kërkesa për kapital	Ekspozimet e ponderuara me rrezik
		VITI-3	VITI-2	VITI I FUNDIT		
		010	020	030		
010	<b>1. TOTALI I AKTIVITETEVE BANKARE SUBJEKT I METODËS SË TREGUESIT BAZIK (BIA)</b>	1,100,186,735	1,058,525,525	1,454,323,928	180,651,809	2,258,147,617

## 10. Rreziku i normës së interesit në librin e bankës

### 10.1 Informacion i përgjithshëm mbi rrezikun e normës së interesit

Banka mat rrezikun e normave të interesit, bazuar në udhëzimin “Mbi administrimin e rrezikut të normës së interesit në librin e bankës” date 30.04.2013, nëpërmjet metodës së vlerësimit të ndryshimit në ekspozimin e librit të bankës duke supozuar një goditje (shock) prej +200 pikësh bazë në kurbën referencë të kthimit.

Sipas kësaj metode Banka shpërndan vlerat aktuale të të gjitha pozicioneve të ndjeshme ndaj normës së interesit në 14 intervale kohore. Pozicionet me normë interesi fikse shpërndahen në intervale kohore sipas maturitetit të mbetur, ndërsa ato me normë interesi të ndryshueshme sipas kohës deri në ndryshimin e ardhshëm të normës së interesit. Pozicioni neto për çdo interval kohor shumëzohet me peshat përkatëse, të cilat llogariten si prodhim i goditjes (shock)-ut të normës së interesit +200 pikësh bazë me kohëzgjatjen e modifikuar për çdo interval kohor. Këto përlllogaritje behën për çdo monedhë kryesore mbi baza individuale dhe për monedhat e tjera mbi baza të agreguara. Pozicioni total neto i ponderuar nuk duhet të tejkalojë nivelin prej 20% të kapitalit rregullator të Bankës..

### 10.2 Raporti i IRRB

Forma totale e IRRBB-s		Totali i pozicioneve të ponderuara	Emri i Bankës / institucionit të kredisë: Banka Amerikane e Investimeve	
			Modeli i raportimit: Data: 30/09/2016	
IRR			Monedha	Shuma
			1	2
1.1.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHES - (FIR+VIR) - monedha LEK		LEK	805,559
1.2.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHES - (FIR+VIR) - monedha EUR		EUR	(310,986)
1.3.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHES - (FIR+VIR) - monedha USD		USD	(15,637)
1.4.	POZICIONET E PONDERUARA NETO SIPAS MONEDHES - (FIR+VIR) - monedha te tjera		Te tjera	(4,677)
2.	<b>NDRYSHIMI NE VLEREN E EKSPOZIMIT</b>		474,259.21	
3.	KAPITALI RREGULLATOR (own funds)		3,334,660.87	
4.	<b>(NDRYSHIMI NE VLEREN E EKSPOZIMIT / KAPITALI RREGULLATOR) * 100</b>		14.22%	

## 11. Rreziku i likuiditetit

### 11.1 Informacion i përgjithshëm mbi rrezikun e likuiditetit

Risku i likuiditetit është përcaktuar si paaftësia e mundshme e një institucioni për të përmbushur detyrimet që ka për shkak të pamjaftueshmërisë së likuiditetit ose pamundësisë për të siguruar financim të mjaftueshëm nga tregu (risku i likuiditetit nga financimi), ose për shkak të vështirësive që lidhen me konvertimin e pozicionit në aktive financiare pa ndikuar negativisht dhe në mënyrë të rëndësishme çmimet, për shkak të kushteve të papërshtatshme ose çrregullimeve të përkohshme të tregut.

Banka Amerikane e Investimeve menaxhon likuiditetin në përputhje të plote me kuadrin rregullator të Bankës së Shqipërisë dhe duke iu referuar praktikave më të mira në treg, duke synuar të sigurojnë një menaxhim efektiv të likuiditetit dhe një profil të sigurtë për riskun e likuiditetit. Banka sigurohet:

- Te jete gjithmone dhe në mënyrë të kënaqshme në gjendje për të financuar rritjen e aktiveve të saj;
- Te jete gjithmone dhe në mënyrë të kënaqshme në gjendje të përmbushë detyrimet e saj;

### 11.2 Aktivet Likuide-Pasivet Afatshkurtra

Niveli i aktiveve likuide dhe pasiveve afat-shkurtra si edhe treguesit e likuiditetit në 30 Shtator 2016 janë si më poshte:

AKTIVET LIKUIDE - PASIVET AFATSHKURTRA						
Kodi		LEKË	USD	EUR	TË TJERA	TOTALI
	(në mijë lekë)					
<b>A</b>	<b>TOTALI I AKTIVEVE LIKUIDE</b>	<b>12,134,903</b>	<b>412,944</b>	<b>3,942,763</b>	<b>141,211</b>	<b>16,631,820</b>
<b>B</b>	<b>TOTALI I PASIVEVE AFATSHKURTRA ME AFAT TË MBETUR MATURIMI DERI NË 1 VIT</b>	<b>12,336,968</b>	<b>743,359</b>	<b>10,377,706</b>	<b>141,301</b>	<b>23,599,334</b>
<b>C</b>	<b>TREGUESI I LIKUJDITETIT (në %)</b>					
1	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (per monedhen kombetare LEK)					98.36%
2	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (per monedhat e huaja)					39.93%
3	Aktive likuide / pasive afatshkurtra * 100 (ne total)					70.48%

### 11.3 Aktivët dhe Pasivët sipas maturitetit

Aktivët dhe pasivët sipas maturitetit të mbetur në 30 Shtator 2016 paraqiten më poshtë:

Kodi	AKTIVET SIPAS MATURIMIT TË MBETUR	DITE	MUAJ				VITE		TOTALI
	(në mijë lekë)	Deri 7	7 dite - 1	1 - 3	3 - 6	6 - 12	1 - 5	> 5	
1	VEPRIME ME THESARIN DHE NDËRBANKARE	3,885,898	599,961	103,437	136,080	370,572	1,447,455	-	6,543,403
2	VEPRIMET ME KLIENTËT	133,992	246,376	944,993	420,119	1,782,869	4,945,814	1,598,008	10,072,171
3	TRANSAKSIONE TË LETRAVE ME VLERË	-	100,055	108,102	83,895	44,456	5,814,525	9,387,804	15,538,836
4	MJETE TË TJERA	296,221	-	-	-	239,518	2,243,769	503,243	3,282,751
	<b>Totali i aktivit</b>	<b>4,316,110</b>	<b>946,392</b>	<b>1,156,532</b>	<b>640,094</b>	<b>2,437,416</b>	<b>14,451,562</b>	<b>11,489,054</b>	<b>35,437,161</b>
	<b>Totali i zerave jashte bilancit</b>	<b>50,443</b>	<b>45,949</b>	<b>45,786</b>	<b>38,217</b>	<b>149,118</b>	<b>80,898</b>	<b>17,568</b>	<b>427,980</b>
	<b>TOTALI I AKTIVIT + TOTALI I ZERAVE JASHTE BILANCIT</b>	<b>4,366,554</b>	<b>992,342</b>	<b>1,202,318</b>	<b>678,311</b>	<b>2,586,534</b>	<b>14,532,461</b>	<b>11,506,623</b>	<b>35,865,141</b>

Kodi	PASIVET SIPAS MATURIMIT TË MBETUR	DITE	MUAJ				VITE		TOTALI
	(në mijë lekë)	Deri 7	7 dite - 1	1 - 3	3 - 6	6 - 12	1 - 5	> 5	
1	VEPRIMET ME INSTITUCIONET FINANCIARE	253,877	-	-	-	-	-	-	253,877
2	VEPRIME ME KLIENTËT	7,516,721	1,658,929	2,917,401	5,233,242	6,534,416	5,088,712	573,044	29,522,465
3	VEPRIME ME LETRAT ME VLERË	-	-	-	-	-	-	-	-
42	DETYRIME TË TJERA	157,783	-	-	-	-	-	-	157,783
5	BURIMET E PËRHERSHME	4,004	29,312	47,488	66,789	179,525	964,214	2,558,547	3,849,879
	<b>Totali i pasivit</b>	<b>7,932,386</b>	<b>1,688,241</b>	<b>2,964,888</b>	<b>5,300,031</b>	<b>6,713,941</b>	<b>6,052,926</b>	<b>3,131,590</b>	<b>33,784,004</b>
	<b>Totali i zerave jashte bilancit</b>	<b>48,743</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>48,743</b>
	<b>TOTALI I PASIVIT + TOTALI I ZERAVE JASHTE BILANCIT</b>	<b>7,981,129</b>	<b>1,688,241</b>	<b>2,964,888</b>	<b>5,300,031</b>	<b>6,713,941</b>	<b>6,052,926</b>	<b>3,131,590</b>	<b>33,832,747</b>

## 12. Politikat e shpërblimit

<http://www.abi.al/wp-content/uploads/2012/11/Politika-e-shperblimit.pdf>

## 13. Politikat kontabël

### 13.1. Bazat e Përgatitjes së Pasqyrave Financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar “Metodologjia e Raportimit dhe Përmbytjes së Raportimit Financiar” të aprovuar nga Banka e Shqipërisë në 24 Dhjetor 2008 dhe kuadrin rregullator dhe kërkesat e Bankës së Shqipërisë.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim letrat me vlerë të vlefshme për shitje, të cilat, të cilat janë matur me më të voglën ndërmjet kostos dhe vlerës së drejtë.. Të dhënat aktuale dhe ato krahasuese janë shprehur në mijë Lekë Shqiptar (“LEK”).

### 13.2. Përmbledhje e politikave kryesore kontabël

Politikat kontabël të përcaktuara më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme për të gjithë periudhën e paraqitur në pasqyrat financiare të Bankës.

#### a) Monedha funksionale dhe prezantuese

Pasqyrat financiare janë prezantuar në LEK, e cila është në të njëjtën kohë edhe monedha funksionale dhe prezantuese e Bankës.

#### b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet e këmbimeve në monedhë të huaj regjistrohen me kursin zyrtar të këmbimit të shpallur në ditën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj konvertohen me kursin zyrtar të këmbimit të shpallur në datën e bilancit. Të gjithë diferencat kalojnë në pasqyrën e të ardhurave e shpenzimeve. Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat e huaja kryesore të përdorura në konvertimin e gjëndjeve të bilancit në monedhë të huaj janë si më poshtë (në LEK):

	<b>30 Shtator 2016</b>	<b>31 Dhjetor 2015</b>
1 USD	122.74	125.79
1 EUR	137.33	137.28
1 GBP	159.14	186.59

Aktivitetet dhe detyrimet jo monetare, përveç kapitalit të nënshkruar dhe rezervave, të emertuar në monedhë të huaj, janë regjistruar me kosto historike dhe konvertuar me kursin e këmbimit të shpallur në datën e transaksionit.

Kapitali aksioner është konvertuar me kursin e këmbimit të datës së bilancit. Diferenca ndërmjet kostos historike dhe gjendjes duke përdorur kursin e këmbimit të datës së bilancit njihen si Rezerva nga Përkthimi në Kapital.

**(c) Mjete monetare dhe ekuivalente**

Mjetet monetare dhe balancat me Bankës Qëndrore të paraqitura në Bilancin Kontabël përfshijnë mjetet monetare në arkë dhe gjendjen me Bankës Qëndrore.

Për qëllim të Pasqyrës së Fluksit të Parasë, Mjetet Monetare dhe Ekuivalentet përbëhen nga mjetet monetare në arkë dhe llogaritë rrjedhëse me Bankën e Shqipërisë, si dhe nga depozitat në bankat e tjera me likuiditet të lartë dhe afat maturimi më të vogël se tre muaj.

**(d) Letrat me vlerë të vlefshme për shitje**

Letrat me vlerë të vlefshme për shitje janë ato letra me vlerë që mbahen për qëllime të investimit afatshkurtër dhe afatmesëm, me përjashtim të atyre letrave me vlerë që Banka i mban deri në maturim dhe përbushin rregullat në lidhje me letrat me vlerë për investim.

Letrat me vlerë të vlefshme për shitje përfshijnë gjithashtu letrat me vlerë të cilat nuk mund të mbahen si letra me vlerë të tregtueshme dhe as si letra me vlerë për investim.

**(e) Huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve**

Huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve dhe bankave të tjera të akorduara nga Banka klasifikohen si hua të akorduara dhe mbahen me koston e amortizuar duke aplikuar normën e interesit nominal, minus ndonjë provigjion specifik. Fshirja e huave bëhet kur një pjesë apo e gjithë huaja përcaktohen si të pakthyeshme.

**(f) Provigjonet specifike dhe statistike për humbjet nga huatë**

Provigjone për humbje nga huatë është vlera e përcaktuar nga Drejtimi e mjaftueshme për të mbuluar humbjet e mundshme të ardhshme nga huatë ekzistuese të cilat mund të bëhen hua të pakthyeshme për shkak të kushteve ekonomike aktuale, cilësisë dhe rrezikut ekzistues në portofolin e huave si dhe faktorëve të tjerë të lidhur, të cilët kërkojnë një vlerësim aktual.

Niveli i kërkuar i provigjoneve përcaktohet nga klasifikimi i rrezikut në pesë kategori në bazë të Rregullove në fuqi (Ligji Nr. 9662 datë 18 dhjetor 2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe Rregullores “Për administrimin e rrezikut të kredisë”, miratuar me Vendimin nr 62 datë 14 Tetor 2001, ndryshuar me Vendimin nr. 27 datë 27 Mars 2011, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.)

Pas përcaktimit të kategorisë përkatëse të rrezikut të ekspozimit, rezervat e nevojshme llogariten duke përdorur përqindjet e mëposhtme sipas kategorisë së rrezikut përkatës:

Kategoria e Rrezikut	Normat e provigjionimit mbi principalin	Normat e provigjionimit mbi interesin
Standarde	1%	1%

Në ndjekje	5%	5%
Nën-standarde	20%	100%
Të dyshimta	50%	100%
Të humbura	100%	100%

### (g) Aktivët afatgjatë materiale

Aktivët afatgjatë materiale mbahen me kosto minus amortizimin e akumuluar. Amortizimi llogaritet sipas metodës lineare për ndërtesat dhe me metodën e vlerës kontabël të mbetur për aktivët e tjera me qëllim shpërndarjen e koston së aktiveve afatgjatë mbi kohën e parashikuar të shfrytëzimit. Amortizimi llogaritet duke filluar nga muaji në vijim të muajit të blerjes.

Përqindjet e përdorura të amortizimit vjetor janë si më poshtë:

Ndërtesat	2.5%
Mjete transporti	20%
Pajisje zyre	20%
Pajisje Kompjuterike	25%

### (h) Aktivët afatgjatë jomateriale

Aktivët afatgjatë jomateriale mbahen fillimisht me kosto minus amortizimin e akumuluar. Aktivët afatgjatë jomateriale përfaqësojnë programin kompjuterik, i cili amortizohet duke përdorur metodën e amortizimit linear mbi kohën e parashikuar të shfrytëzimit prej katër vjetësh dhe shpenzimet e nisjes, të cilat dhe këto amortizohen sipas metodës lineare mbi kohën e parashikuar të shfrytëzimit prej 4 vjetësh. Amortizimi llogaritet duke filluar nga muaji në vijim të muajit të blerjes.

### (i) Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen duke marrë në konsideratë që është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike do të rrjedhin drejt Bankës dhe këto përfitime mund të llogariten në mënyrë të besueshme. Të ardhurat nga interesi që konsiderohen si pjesë e rëndësishme e të ardhurave efektive të një huaje vlerësohen në bazë të metodës së të drejtave të konstatuara dhe duke përdorur metodën e normës efektive të kthimit, përveç interesave të huave nën-standarde, të dyshimta dhe të humbura, të cilat regjistrohen si të ardhura në momentin kur fitohen. Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve dhe nga komisionet mbahen për shërbimet financiare të ofruara nga Banka, përfshirë këtu shërbimet e administrimit të parave, shërbimet e ndërmjetësimit mbi këshillimet e investimit. Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve dhe nga komisionet regjistrohen si të ardhura në momentin kur shërbimi kryhet. Tarifat e disbursimit të huasë shtyhen dhe njihen në periudhën me të cilat ato lidhen në bazë të kohëzgjatjes së huasë përkatëse.

### (j) Përfitimet e punonjësve (detyrime për pensione)

Banka operon sipas një plani të përcaktuar për pensionet. Banka paguan kontributet për punonjësit e saj, në shoqërinë e pensioneve të zotëruar nga Shteti, mbi baza mujore dhe në mënyrë të detyrueshme. Banka nuk ka detyrime të tjera përveç pagesës për kontributet. Kontributet njihen si shpenzim në lidhje me përfitimet e punonjësve kur këto kontribute janë të detyrueshme për t'u paguar.

### (k) Qiraja dhe përmirosimet e qirasë



Përcaktimi nëse një marrëveshje është ose përmban një qera, bazohet në thelbin e marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi ose aktiveve të caktuara dhe marrëveshja njih të drejtën për të përdorur aktivin.

Banka ka vetëm marrëveshje qeraje operative, pagesat e të cilave njihen në pasqyrën e të ardhurave në mënyrë lineare gjatë kohëzgjatjes së qerasë. Kostot e ristrukturimit të kryera në këto ambiente që përdoren në bazë të këtyre marrëveshjeve kontabilizohen si aktive të tjera dhe amortizohen gjatë kohëzgjatjes së qerasë në mënyrë lineare.

### **(l) Huamarrjet**

Huamarrjet njihen fillimisht me vlerën e drejtë minus kostot e transaksionit. Kreditë në vijim mbahen me kosto të amortizuar. Çdo diferencë mes shumës së disbursuar minus kostot e transaksionit dhe vlerës së kthyer njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë kohëzgjatjes së huamarrjes duke përdorur metodën e interesit efektiv.

### **m) Provigjone**

Provigjonet për çështjet gjyqësore regjistrohen kur Banka ka një detyrim aktual ligjor ose që rrjedh nga praktika e mëparshme si rezultat i ngjarjeve të mëparshme; ka më shumë mundësi sesa jo që të ketë dalje të burimeve në mënyrë që të mbyllet detyrimi; dhe kur vlera e detyrimit është vlerësuar në mënyrë të besueshme.

### **(n) Kapitali aksionar**

#### *Kapitali i paguar*

Kapitali i paguar përfaqëson fondet e investuara nga aksionerët. Kapitali i paguar përbëhet nga aksione të zakonshme të emetuara nga aksionarët.

#### *Rezerva ligjore*

Rezerva ligjore përfaqëson shumat e akumuluar nga kapitalizimi i fitimit të viteve paraardhëse bazuar në legjislacionin bankar me qëllim krijimin e një rezerve për të mbuluar humbjet e mundshme që mund të lindin gjatë aktivitetit normal të Bankës.

#### *Diferenca e rivlerësimit*

Diferencat e rivlerësimit përfshijnë diferenca ndërmjet kapitalit aksioner duke përdorur kursin e këmbimit në datën e rritjes së kapitalit dhe atij të fundvitit. Diferenca paraqitet si rezervë rivlerësimi, pjesë e kapitalit aksioner.

### **(o) Tatimi mbi fitimin**

Tatimi mbi fitimin llogaritet në përputhje me dispozitat e Legjislacionit Shqiptar mbi tatimin mbi fitimin.

Fitimi i tatueshëm llogaritet duke korigjuar fitimin para tatimit për disa shpenzime dhe të ardhura të përcaktuara si të pazbritshme/të patatueshme në Legjislacionin Shqiptar. Shpenzimet për tatimin mbi fitimin përfshijnë gjithë detyrimet për tatimin mbi fitimin e vitit ushtrimor aktual. Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar "Metodologjia e Raportimit dhe Përmbajtjes së Raportimit Financiar" të aprovuar nga Banka e Shqipërisë në 24 Dhjetor 2008 dhe kuadrin rregullator dhe kërkesat e Bankës së Shqipërisë.

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike, me përjashtim letrat me vlerë të vlefshme për shitje, të cilat, të cilat janë matur me më të voglën ndërmjet kostos dhe vlerës së drejtë.. Të dhënat aktuale dhe ato krahasuese janë shprehur në mijë Lekë Shqiptar ("LEK").

#### **(q) Transaksionet e zërave jashtë bilancit**

Transaksionet e zërave jashtë bilancit përfaqësojnë marrëveshjet midis bankave dhe paleve të tjera. Këto marrëveshje përfaqësojnë të drejtat dhe angazhimet të cilat ka mundësi të sjellin një të drejtë ose detyrim në zbatim të kushteve kontraktuale. Njohja ndodh në momentin e nënshkrimit të kontratës. Angazhimet mbartin një rrezik të mundshëm të kredisë e cila shpërblehet me një komision. Për angazhime të caktuara, krijohet një provigjon për të mbuluar rrezikun e mundshëm të kredisë. Mosnjohja ndodh nëse e drejta ose detyrimi respektiv realizohet në datën e mbarimit / maturimit të kontratës.

#### **(r) Korrigjimi i gabimeve**

Në përputhje me manualin e politikave kontabël të Bankës Qëndrore, gabimet korrigjohen në vitin financiar në të cilin zbulohen, dhe nuk kanë efekt në retrospektiv. Impakti i këtyre korrigjimeve njihet në pasqyrën e të ardhurave të vitit.

#### **(s) Të dhënat krahasuese**

Të dhënat krahasuese janë riklasifikuar kur ka qënë e nevojshme, për t'ju përmbajtur ndryshimeve në prezantimin e vitit aktual. Megjithatë këto riklasifikime nuk kanë rezultuar në ndryshime të rëndësishme të përmbajtjes dhe paraqitjes së informacionit financiar sic janë paraqitur në pasqyrat financiare.